SHABAN ÇUPI

Hani i Elezit,

në kohën e Perandorisë Osmane

ishte han apo Post-Han?

Gjurmëve të gjenezës së Hanit të Elezit

Hani i Elezit, në kohën e Perandorisë Osmane ishte han apo Post-Han?

Në hulumtim të gjenezës së Hanit, në librin ***Panoramë e trashëgimisë kulturore në trevën e Hanit të Elezit***, kemi konstatuar se themelues i Hanit ishte Elezi dhe ishte nga fshati Dimcë i kësaj treve.
Në rrjedhë të hulumtimeve, sidomos të udhëpërshkrimeve të Johann George Hanit i cili kësaj treve hulumtoi në vitin 1858, në librin e tij ***Reise von Belgrad nach Salonik***, botuar në Vjenë në vitin 1868, shkruan se*:*
Wir übernachteten in dem geräumigen Post-Chane, Welcher einem Albanesen gehört, dessen Aeusseres mehr auf einen Palikarenchef als auf einen Wirth…

Ne e kaluam natën në një Post - Han të madh i cili i takonte një shqiptari, pamja e të cilit të linte të kuptonte një kapedan palikar (trim, guximtar) se sa të një hanxhiu.

Që në rreshtat e parë, austriaku Johan Han (1811-1869), na jep një informacion të dobishëm për trevën tonë ku thotë se ne qëndruam, ***Wir übernachteten*** ne e kaluam natën, pra kanë buajtur në një Post- Han të madh ***in dem geräumigen Post-Chane*** …

Çka ishin Post-Hanet në kohën e Perandorisë Osmane?

Post - Hani ishte han me detyrë shtetërore për shërbim të postës dhe transportit zyrtar, ku ndërroheshin kuajtë, pushonin postierët ku merrej dhe dorëzohej posta, po ku edhe pushonin ose qëndronin njerëz si në këtë rast të Johan Hanit. Por, Post – Hanet e që ndryshe në sistemin e Postës

Osmane quheshin **Menzilhane** ishin më shtetërore në krahasim me hanet e zakonshme që ishin civile.

Post-Hani më i madhë, apo qendra e Post Haneve ishte Shkupi si kryeqytet i Vilajetit të Kosovës, prej kah pastaj shpërndahej posta, në këtë rast në drejtim të Grykës së Kaçanikut, por karakteristikë tjetër është se Gryka, ka pasur dy Post - Hane të tilla, njëri në hyrje (Hani i Elezit) e tjetri në dalje, pra në Kaçanik.

Pse dy Post-Hane në një distancë të shkurtër 10 kilometërshe?

Sepse në atë kohë, Gryka e Kaçanikut ishte mbushur me kaçakë, me cuba, me kusarë dhe këtë e vërtetojnë shumë udhëpërshkrues, ku plaçkitej çdo send, madje edhe vriteshin tregtarë, zyrtarë e kadilerë e në kontekst të kësaj kërkohej një siguri më e madhe në krahasim me Post-Hanet tjera në Rrafshin e Kosovës. Pra, thënë më shkurt, Gryka e Kaçanikut ishte një vend me shumë rreziqe.

Deri në këtë pikë të paragrafit kuptuam se Johan Hani, i cili ndryshe njihet edhe si themeluesi i albanologjisë shqiptare, pastaj konzul i Perandorisë Austriake në Janinë e Prevezë ka qëndruar në Hanin e Elezit, ka fjetur dhe të nesërmen ka udhëtuar në drejtim të Grykës së Kaçanikut.

Në vazhdim të paragrafit, tani kemi përshkrimin e hanxhisë.

Ky han i takonte një shqiptari, pra e specifikon qartë se ishte i një shqiptari, ***einem Albanesen gehört*** pra hani kishte pronarë e që Johan Han e konkretizon në librin tjetër të udhëtimeve të tij **Nga Drini në Vardar** se

ishte i Elezit dhe e evidenton për herë të parë në hartë në vitin 1967 në formën Elez H. (Më gjerësisht shih librin Panoramë e trashëgimisë kulturore… nga i njejti autorë Shaban Çupi)

Duke përshkruar pamjen e hanxhisë, Jahan Hani thotë se ai i përngjante një ***Palikarchefi*** e që në përkthim të lirë i bie se më shumë i përngjante një komandanti, një kapidani pra të një njeriu guximtar se sa një hanxhiu të cilët nga natyra e tyre e punës janë më të butë.

Po pse Johan Hani e quan Post- Han të madh ***in dem geräumigen Post-Chane***?

Post- Hanet ose në gjuhën osmane Mezil Hanet, për nga përmasat ishin të mëdhaja dhe të vogla. Johan Hani, hanin e kësaj treve e quan të madh, pra mjaftë të rëndësishëm sepse ka luajtur shumë funksione, ndërsa në Rrafshin e Kosovës ka pasur Post Hane të vogla të cilat shpesh ishin pika postare ndërmjet dy Post Haneve të mëdhaja.

A mund ta konkretizojmë se kur Johan Hani qëndroi në Post-Hanin e Hanit të Elezit?

Po. Në kontekst të shkrimit të tij dhe udhëtimeve, bëhet fjalë për fundin e tetorit të vitit 1858.

Kur u shuan Post-Hanet apo menzilhanet?

Me ngritjen e hekurudhës Shkup-Mitrovicë në vitin 1873/74, u shuan edhe Post-Hanet (menzilhanet) sepse tanimë shërbimet postare kryheshin nëpërmjet stacioneve hekurudhore. Në këtë rast shuhet edhe Post-Hani i

Hanit të Elezit, por tradita e haneve vazhdon edhe më tej, por tanimë në shërbim krejtësisht civil për tregtarë dhe bujtinë për udhëtarë.

Aktualisht ne nuk kemi të dhëna se kur u ngrit stacionit hekurudhorë si objekt, por e dimë se vija hekurudhore si vijë qarkulluese për udhëtarë e mallëra në trevën e Hanit të Elezit daton nga viti 1874.

SHABAN ÇUPI, GUSHT, 2025